# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446168**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dibrani denoncon: Bizneset po na zënë hapësirat publike për parkim privat |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391819.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 13:25:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 13:13:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 13:12:00 UTC → 15 shtator 2026, 13:14:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ee30efe713eefb85f7951b92de03b246d09e40295d9e41def6f6fa668cae3516` |
| TEKSTI | `a10ed2cca7727769d40d7f7cd1c7df5478768909d6b915b517682bf0c289dc36` |
| PAMJA | `a1b71a9795f1309ff3bf91f466328cbd92f117c537dcc28ae8313870ec1ff1ce` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `77c3062b0dad56e994a4802b98deebbd7011e84b6ca895acba726d228d6a118f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/77c3062b0dad56e994a4802b98deebbd7011e84b6ca895acba726d228d6a118f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dibrani denoncon: Bizneset po na zënë hapësirat publike për parkim privat

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 15.09.2026, 15:13

Share Share




Një qytetar ka ngritur një shqetësim lidhur me situatën e parkimit në qytetin e Peshkopisë, duke treguar se biznese private po marrin në përdorim hapësira publike për t'i shfrytëzuar si parkime private.

Sipas qytetarit, mungesa e hapësirave publike për parkim po vështirëson ndjeshëm jetën e banorëve, veçanërisht të familjeve që nuk kanë mundësi financiare për të paguar për një vend parkimi privat.

"*Pse duhet t'ua shesim rrugët e qytetarëve privatëve? Pse bashkia nuk i kthen këto hapësira në parkime publike me orar*?", shprehet qytetari në denoncimin e tij.

Ai ngre gjithashtu shqetësimin se, për shkak të mungesës së parkimeve, qytetarët detyrohen t'i lënë automjetet në rrugë edhe në raste emergjente, si për të shkuar në farmaci apo për të kryer shërbime të tjera të nevojshme.

Sipas tij, qytetarët përballen me gjoba dhe masa të tjera ndëshkuese kur parkojnë në vende të palejuara, ndërsa hapësirat që mund të shërbenin për parkim publik, pretendohet se po përdoren nga subjektet private.

"*Duam të blejmë diçka në farmaci, por nuk ka parkim. Jemi të detyruar ta lëmë makinën në rrugë*", shprehet më tej qytetari.

Denoncimi ngre pikëpyetje mbi mënyrën e administrimit të hapësirave publike dhe kërkon një reagim nga Bashkia Dibër lidhur me kriteret dhe procedurat për dhënien në përdorim të hapësirave publike për parkim.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike
ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.